

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, *Luljete Shabani*, me zyrtaren ligjore, *Hikmete Veliu-Pajaziti*, në lëndën penale ndaj të akuzuarit **B. V** nga Gj, të cilin me autorizim e mbron av...., për veprën penale, *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*, nga neni 275, par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II nr.828/2017, e datës 22.05.2017, e sipas Marrëveshjes për pranimin e fajësisë, të datës 22.05.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar e publik, më datën 16.08.2017, mori dhe në prezencë të palëve shpalli, ndërsa, më dt. 17.08.2017, përpiloi këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari **B. V**, nga babai **Z**.dhe nëna **E**, e lindur **B**, i lindur më datë ...në Gj, ku edhe jeton, në rr. “...” pn., i pamartuar, i papunë, punon, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë SHTË F A J T O R

Sepse, më datë 16.05.2017, rreth orës 20.00 min. , në afërsi të palestrës sportive, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit “...”, në atë mënyrë që derisa ishte duke qëndruar me shokun e rij në parkun prapa palestrës sportive, pas kontrollit të zakonshëm policor, në xhepin e djathtë të pantallonave i është gjetur substancë dyshimtë , e cila i është sekuestruar dhe pas testit fushor nga Njësi të Policinë e Kosovës, ka rezultuar të jetë substancë narkotike e llojit “...”, në peshë prej ...që si e tillë është shpallur si substancë e rrezikshme sipas Ligjit mbi barnat dhe substancat psikotrope dhe precursor ,

-me çka ka kryer veprën penale, *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*, nga **neni 275 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së**, andaj, Gjykata, bazuar në dispozitat e neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit B. V., me dënim burgu në kohëzgjatje prej **120 (njëqind e njëzetë) ditëve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1(një) viti** nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Obligohet i akuzuari që në bazë të Ligjit për kompensimin e viktimave neni 39 par.3 nën par. 3.1, të paguajë taksën në shumën prej 30 €.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej **20 (njëzetë) €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Në bazë të neni 275 par.3 dhe nenit 62 par.2 pika 2.7 lidhur me nenin 69 par.1 të KPRK-së deh nenit 282 par.2 pika 2.4 të KPPRK-së i konfiskohet sasia e narkotikut në peshë prej.... E llojit marihuana.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë PP.II nr.828/2017, e datës 22.05.2017, kundër të akuzuarit B. V, për veprën penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge, nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritore sipas ligjit.

Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, përmes prokurorit të shtetit Leonora Shemsiu-kadriu, kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me të pandehurin A. S. dhe mbrojtësin e tij av.....

Prokurori i shtetit, Leonora Shemsiu-Kadriu, në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë të mbajtur më datë 16.08.2017, deklaroi se për një gjë të tillë kanë pasur autorizim edhe nga kryeprokurori dhe këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e kanë nënshkruar së bashku duke përfshirë këtu kryeprokurorin, të pandehurin, mbrojtësin e tij dhe prokurorja në fjalë, andaj, kërkojnë nga gjykata që ta pranojë marrëveshjen me nr. PP.II.nr.828/2017, të datës 22.05.2017.

Mbrojtësi i të pandehurit, av..., deklaroi se mbetet pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe kërkoi nga gjykata që ta pranojë këtë marrëveshje.

I pandehuri B.V, deklaroi se e mbështet në tërësi deklaratën e mbrojtësit së tij, pasi që marrëveshjen për pranimin e fajësisë e ka nënshkruar në mënyrë vullnetare, i vetëdijshëm se çka përmban e njëjta, paraprakisht është konsultuar me mbrojtësin e tij, është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale ndërsa nuk ka qenë i kërcënuar apo mashtruar për ta nënshkruar këtë marrëveshje, andaj edhe ky kërkoi nga kjo gjykatë që ta pranojë këtë marrëveshje. Gjithashtu, në fjalën përfundimtare deklaroi se është penduar dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm që të mos bie ndesh me ligjin.

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë, mori aktvendim me të cilin e pranoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, dhe i njoftoi palët se pasi që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është arritur me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë, nuk i lejohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, e as prokurorit të shtetit që të tërhiqen nga kjo marrëveshje mbi pranimin e fajësisë pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara në nenin 233 par. 18 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari pati sjellje korrekte në Gjykatë, se është penduar për veprën në fjalë, ndërsa si rrethanë rënduese, mori parasysh rrezikshmërinë shoqërore dhe pasojat e dëmshem të veprës penale, me bindje se një dënim i tillë është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me të do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK -së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 504/2017, më datë 17.08.2017**

Z. Ligjore,
Hikmete Veliu – Pajaziti

Gjykatësja e vetme gjyqësore ,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Palët kanë hequr dorë nga ankesa kundër këtij aktgjykimi.